
Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 7 Nentor 2005 ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Mbi Shoqerite tregtare". NUIS –i i shoqerise eshte K61716013M.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 15,600,000 Leke (pesembedhjete milion gjashteqind mijë Leke), I cili zoterohet nga dy ortaket e tij qe jane:

- Z. Vladimir PJETERGJOKAJ 53%.
- Z. Kujtim ARIFAJ 47%

Shoqëria ushtron veprimtarine e saj në fushën e ndërtimit.

Zyra qëndrore e Shoqërisë ndodhet në Rrugën "Muzakët", Pallati Vokshi, Kati 7, Tirane.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

Vlerësimi dhe gjykime

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimë dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimesht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimë dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të prishme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Sic paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet tē përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkeseve të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvèc rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël tē mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 31.12.2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi kemibimit ne vitin 2020 ne krakasim me 2019 eshte si me poshte:

	2020	2019
1. Monedha ne euro	123.70	121.77
2. Monedha dollare	100.84	109.64

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Instrumente de finanțare

Instrumentat finanziarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat finanziarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksiioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat finanziarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finanziar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfugizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitetë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua tē marra dhe tē dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njoftes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njoftur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njoftura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjerë

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur cdo humbie nga zhylërsimi.

Vlerat janë në lek, përvèç kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitalithemeltar

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoħjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Inventarët

Inventarët registrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-nđërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	0 %
Instalime teknike, ,makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	2%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	0 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	0 %
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	0.4%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferenca të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetem qira operative

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesи mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvëç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatilemës në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 eshte 15% (2019: 15%).

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqites së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në Lekë	60.604.712	21 310 075
Arka	1.592.942	13 738 088
Banka	59.011.770	7 571 987
 Mjete monetare në valutë	 9.255.085	 90.531.121
Arka	1.466.587	2.912.495
Banka	7.788.498	87 618 626
Totali.....	69.859.797	111.841.196

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Te arketueshme nga klientë	763.508.480	1.002.619.751
	763.508.480	1.002.619.751

6. Te tjera Llogari te arketueshme

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Nr	Emertimi	Lek
1	Tatim Fitimi Gjendje me 31.12.2020	20,712,537
2	Tvsh gjendje	6,701,124
3	Pevlaku Kosove	198,348,000
4	Petrit Imeraj	7,422,000
5	Kom Prokurimeve Publike	4,400,655
6	Zuzana Hoxha	500,000
7	Eduart Mrishaj	2,474,000
8	Drejtoria Pergj Doganave	5,526,992
	Shuma	246,085,308
		231,402,021

7. Shpenzime te shtyre per per shumen 9.100.856 lek

Perfaqesojne punime te kryera per vitin 2021 ne Objektin e Rindertimit nga Termeti ne Durres.

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Gjendja e Aktiveve Afatgjata Materiale ne date 31.12.2020

Emertimi	Toka ,terrene, troje	Ndertim.In stalime pergjithsh me	Instalime teknike Makineri Pajisje	Mjete transporti	shuma	Pajisje zyre dhe orendi	Pajisje informatik e	Totali
1	2	3	4	5	6(7+8)	7	8	9(2+3+4+5+ 6)
Aktive te Trupezuara								
Gjendje 01.01.2020	18,573,800	19,790,977	30,485,258	148,834,191	13,281, 189	1,748,074	11,533,11 5	230,965,415
Shtesa	-	616,983	446,275	620,000	1,139,9 12	263,091	876,821	2,823,170
Shuma	18,573,800	20,407,960	30,931,533	149,454,191	14,421, 101	2,011,165	12,409,93 6	233,788,585
Pakesime	-	-	5,651,101	9,786,609	-	-	-	15,437,710
Gjendje 31.12.2020	18,573,800	20,407,960	25,280,432	139,667,582	14,421, 101	2,011,165	12,409,93 6	218,350,875
Amortizimi	-	-			-			-
Gjendje ne 01.01.2020	-	3,851,842	19,986,371	64,706,898	7,545,5 09	543,448	7,002,061	96,090,620
Shtesa llogaritur	-	-	228,944	335,166	-	-	-	564,110
shuma	-	3,851,842	20,215,315	65,042,064	7,545,5 09	543,448	7,002,061	96,654,730
Pakesime	-	-	3,820,168	8,350,422	-	-	-	12,170,590
Gjendje ne 31.12.2020	-	3,851,842	16,395,147	56,691,642	7,545,5 09	543,448	7,002,061	84,484,140
					-			
Vlera neto 01.01.2020	18,573,800	15,939,135	10,498,887	84,127,293	5,735,6 80	1,204,626	4,531,054	134,874,795
Vlera neto 31.12.2020	18,573,800	16,556,118	8,885,285	82,975,940	6,875,5 92	1,467,717	5,407,875	133,866,735

Ak ne proces 31.12.20	1,279,224	39,571,721	40,850,945
--------------------------	-----------	------------	------------

Totali 31.12.2020			174,717,680
----------------------	--	--	-------------

- **Parapagime per aktive ne proces .**

Gjendja me 31.12.2020 per shumen **40.850.945 lek** dhe perfaqeson shpenzime per Objektin ne Vore : "**Godine sherbimi dhe servis automjetesh 2/kate + mur rrethues**" sipas lejes ndertimit Nr 2969/5 date 03.07.2019.

9. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë përfshirë llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë	693.775.093	790.885.114
	693.775.093	790.885.114

6. LLOGARI TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

Emertimi	Viti 2020	Viti 2018
Vladimir Pjetergjokaj	101.152.319	113.410.694
Kujtim Arifaj	39.042.698	111.214.000
shuma	140.195.017	224.624.694

7. DETYRIMET TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrimi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	778.512	832.373
Tatimi mbi të ardhurat personale	101.959	315 252
TVSH për tu paguar	0	0
Tatimi mbi fitimin	0	0
Detyrime të tjera	0	0
Shuma	880.471	1.147.625

8. KAPITALI

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Vlera e	% e	Vlera e	% e
	kapitalit	kapitalit	kapitalit	kapitalit
Kujtim Arifaj	7,322,000	47%	7,322,000	47%
Vladimir Pjetergjokaj	8,268,000	53%	8,268,000	53%
Totali	15,600,000	100%	15,600,000	100%

9. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga ndërtimet	119.288.217	90.336.540
Të ardhura nga prodhimi dhe shitje AQ	42.477.863	200.927.616
Totali	161.766.080	291.264.156

Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne

Qarkullim i tatushëm	161.766.140
Zbriten të ardhura nga shitja e aktiveve bruto	0
Shtohet fitimi nga shitja e aktiveve	0
Shpenzime nga këmbimet valutore paraqiture te të ardhurat e tjera të shfrytëzimit	499.082
Shuma e qarkullimit e korrektuar	161.655.187
Sipas Kontabilitetit.	161.655.187
Diferenca	0

10. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë: të ardhura nga shitja e aseteve dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shitja AAGJM	3.491.140	7.009.267
Prodhimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
Shpen nga këmbimet valutore për marrëdhenie tregetare	0	0
	3.491.140	7.009.267

**11. LËNDË TË PARA DHE MATERIALE
TËKONSUMUESHME**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave dhe lëndeve të para që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Blerje materialesh	40.821.929	124.189.761
	40.821.929	124 189 761

11. TË TJERA SHPENZIME

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Punime nga nënkontraktorë	84.117.643	58.494.036
Mirëmbajtje dhe riparime	1.398.708	2.382.903
Shpenzime telekomunikacioni		1.362.447
Tarifa vendore dhe taksa të tjera		1.967.829
Shpenzime sigurimi		3.232.430
Shërbime nga të tretët		330.900
Qira		360.000
Shpenzime bankare		207.663
Shpenzime të tjera	833.760	56.966
Shuma	86.350.111	68.395.174

12. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime page	34.900.000	49.074.493
Shpenzime për sigurimet shoqerore dhe shëndetësore	5.513.191	6.750.162
	40.413.191	55.824.655

13. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime amortizimi	564.110	11.473.369
	564.110	11.473.369

14. SHPENZIME TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
SHPENZIME TE TJERA	12.137.856	8.309.696
	<u>12.137.856</u>	<u>8.309.696</u>

15. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime interesi,	0	0
Të ardhura nga interesi	383.900	11.187
<u>Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare</u>	<u>-159.807</u>	<u>-709.051</u>
<u>Shuma</u>	<u>224.093</u>	<u>-697.865</u>

16. TATIMI MBI FITIMIN

Përllogarita e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	-18.297.024	24.254.398
Shpenzime të panjohura	0	4.020.642
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	-18.297.024	28.275.209
<i>Tatim fitimi @15%</i>	0	4.241.281
Fitim/humbje e vitit	-18.297.024	20.013.117

17. PALËT E LIDHURA

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, për shembull aksionerët e shoqërisë, dhe njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose që kanë një ndikim të konsiderueshmë nga palët e tillë. Politikat e tarifimit dhe kushtet e këtyre transaksioneve janë aprovuar nga manaxhimi.

Balancat me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>		<u>31 dhjetor 2019</u>	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
PE-VLA-KU Kosovë	198.348.000	0	197.909.616	0
Dividend per tu paguar		20.013.117	0	200.000.000
	198.348.000	20.013.117	0	197.909.616
			197.909.616	200.000.000

PE-VLA-KU SH.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Vlerat janë në lek, përvèç kur shprehet ndryshe

25. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financier të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

26. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINACIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kérkonin korrigim ose shënime në pasqyrat financiare.

ADMINISTRATORI

Vladimir Pjetergjokaj



Hartuesi I Pasqyrave Financiare

Gjovalin Fusha